

# 1FUTURE

## jOiNEd For sUsTainability - bUilding climate REsilient communities in WB and EU

**DELIVERABLE NR. 2.2**

Plan for Climate Action

**DUE DATE: 31/07/2024**

**MAIN AUTHOR: UPT**

**CONTRIBUTORS: <PARTNERS ACRONYM>**

<https://1future.feut.edu.al/>



**Co-funded by  
the European Union**

<b>Nr. i dokumentit</b>	D2.2
<b>Paketa e Punës</b>	WP2
<b>Autorët</b>	Prof. Dr. Oltion Marko (UPT) Prof. Asoc. Konalsi Gjoka (UPT) Dr. Entela Çobani (UPT) Dr. Ledia Aleksi (UPT) Prof. Asoc. Joana Gjipalaj (UPT)
<b>Data</b>	03.06.2024
<b>Emri i dokumentit</b>	
<b>Statusi</b>	
<b>Rishikimi</b>	
<b>Rishikuar nga (nqs ka)</b>	

**Klasifikimi:**

<i>Projekt</i>	<input type="checkbox"/>
<i>Përfundimtar</i>	<input checked="" type="checkbox"/>
<i>Konfindencial</i>	<input type="checkbox"/>
<i>I Kufizuar</i>	<input type="checkbox"/>
<i>Publik</i>	<input type="checkbox"/>



**Co-funded by  
the European Union**

Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or EACEA. Neither the European Union nor the granting authority can be held responsible for them.

### Version History

Version	Implemented by	Revision Date	Changes Description
V1.2	UPT		Draft

This document has been prepared in the framework of the European project 1FUTURE.

Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or EACEA. Neither the European Union nor the granting authority can be held responsible for them.



**Co-funded by  
the European Union**

CONTACT:

Website: [1future.feut.edu.al](http://1future.feut.edu.al)

E-mail: [1future@feut.edu.al](mailto:1future@feut.edu.al)



**Co-funded by  
the European Union**

Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or EACEA. Neither the European Union nor the granting authority can be held responsible for them.”

### Contents

#### HYRJE 4

<b>1</b>	<b>KAPITULLI 1: ARSIMI I LARTË DHE VEPRIMI PËR KLIMËN .....</b>	<b>5</b>
<b>2</b>	<b>KAPITULLI 2: VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM LIDHUR ME QËNDRUESHMËRINË DHE PLANIN E VEPRIMIT PËR KLIMËN .....</b>	<b>6</b>
2.1	QËNDRUESHMËRIA MJEDISORE NË FUSHËN AKADEMIKE: TË MËSUARIT, KËRKIMI SHKENCOR DHE MËSIMDHËNIA .....	7
2.2	QYTETARIA, QËNDRUESHMËRIA .....	7
2.3	VEPRIMI PËR KLIMËN .....	7
2.4	REDUKTIMI I MBETJEVE DHE EKONOMIA QARKULLUESE .....	7
2.5	PEJSAZHI DHE BURIMET NATYRORE .....	8
2.6	UDHËTIMET PËR PUNË DHE LËVIZJET .....	8
2.7	SIGURIA USHQIMORE DHE MIRËQËNIA .....	8
<b>3</b>	<b>KAPITULLI 3 : MONITORIMI DHE RAPORTIMI .....</b>	<b>8</b>
<b>4</b>	<b>PLANI I VEPRIMIT .....</b>	<b>1</b>



Co-funded by  
the European Union

Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or EACEA. Neither the European Union nor the granting authority can be held responsible for them.”

### Hyrje

Në kuadër të projektit 1FUTURE, paketës së punës numër 2, është parashikuar të përgatitet dhe të aprovohet nga instancat përkatëse, një Plan Veprimi për Klimën, në secilin institucion të arsimit të lartë në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Ky plan është rezultat i pikës së projektit 2.5 dhe është hartuar duke u bazuar në gjetjet e pikës së mëparshme të paketës së punës 2, specifiku në rezultatet e analizës së mangësive në këto institucione dhe vizitave studimore në vendet partnere të BE-së.

Analiza e mangësive të nismave për qëndrueshmërinë dhe klimën midis Institucioneve të arsimit të lartë të vendeve të Ballkanit perëndimor dhe vendeve të Bashkimit Europian, nxorri në pah ndryshime të mëdha lidhur me kuadrin strategjik dhe ligjor kombëtar, kuadrin institucional, kurrikulat, projektet dhe kërkimi shkencor, si edhe shërbimet e praktikave në këto institucione.

Situata në institucionet e arsimit të lartë në vendet e BE-së, tregoi që kemi një përfshirje të qëndrueshmërisë mjaft të mirë në kuadrin institucional, një model gjithëpërfshirës dhe të strukturuar për arsimin e qëndrueshëm, me programe të fokusuara dhe integrim më të gjerë, me shërbime dhe praktika të ndryshme të fokusuara në qëndrueshmërinë dhe klimën.

Ndërsa, institucionet e arsimit të lartë në vendet e ballkanit perëndimor përballen me sfida të vazhdueshme për përmbushjen e standarteve ndërkombëtare, përdorim të kufizuar të burimeve dhe zbatim në fazat më të hershme, mungesë të kuadrit specific institucional, mungesë të kurrikulave të fokusuara në ndryshimet klimatike dhe në praktikave të qëndrueshmërisë, pabarazi në integrimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të) në programe të ndryshme të specializuara, projekte dhe kërkim shkencor me një model më të fokusuar, mangësi për të siguruar shërbime dhe praktika lidhur me sfidat për qëndrueshmërinë dhe klimën.



**Co-funded by  
the European Union**

Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or EACEA. Neither the European Union nor the granting authority can be held responsible for them."

Analiza dhe identifikimi i mangësive në nismat për qëndrueshmërinë dhe ndryshimet klimatike midis IAL në vendet e Ballkanit perëndimor dhe atyre të BE-së, ndihmon në vendet e ballkanit perëndimor për të përmirësuar këto iniciativa. Plotësimi i mangësive të vëna re ndihmon IAL-të e vendeve të Ballkanit perëndimor të pozicionohen ndërkombëtarisht më lart, nxit njohjen e tyre për plotësimin e standarteve globale për qëndrueshmërinë. Përafrueshmëria me praktikatat e BE-së krijon mundësinë për bashkëpunime, projekte të përbashkëta, dhe kërkime shkencore të përbashkëta, duke siguruar IAL-të e Ballkanit perëndimor të kenë akses në burime dhe në një rrjet bashkëpunimi shumë të gjerë.

Qëllimi i Planit veprimi për klimën është që të plotësojë mangësitë duke zbatuar një plan klime në të ardhmen në IAL-të e Ballkanit perëndimor. Miratimi dhe zbatimi i tij do të pozicionojë IAL-të e Ballkanit perëndimor si kontribues kryesor në përpjekjet e qëndrueshme kombëtare, duke patur ndikim pozitiv në arsim, kërkim shkencor dhe mbrojtjen e mjedisit.

## 1 Kapitulli 1: Arsimi i Lartë dhe Veprimi për Klimën

Plani i Veprimi për Klimën ka si qëllim plotësimin e aktiviteteve tona kërkimore, mësimore dhe shkencore në mbështetje të qëndrueshmërisë. Propozimi ynë është identifikimi i shtatë fushave në të cilat ai do të zbatohet, me fokus në Veprimet për Klimën si pikë takimi e tyre, për përballimin e krizës klimatike. Kohëzgjatja e këtij plani parashikohet të jetë nga 2024 – 2029. Synimi është që ky plan të ketë një jetëgjatësi më të madhe dhe të shërbejë për të nxitur bashkëpunimin midis shkollave, bizneseve, shoqatave studentore dhe njësi të tjera në fakultet.

Vizioni i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN) është të jetë një Institucion Publik i arsimit të lartë me cilësi të lartë dhe lider në fushat e tij të ekspertizës. Ai ka për qëllim përmirësimin dhe forcimin e stafit akademik dhe zgjidhjen e problemeve të rëndësishme shkencore dhe kërkimeve në nivel kombëtar dhe rajonal.

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit me aprovimin e këtij plani, ka si qëllim të jetë një fakultet lider në zbatimin e veprimeve për klimën dhe qëndrueshmërinë, nëpërmjet kërkimeve shkencore,



Co-funded by  
the European Union

Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or EACEA. Neither the European Union nor the granting authority can be held responsible for them.”

demonstrimit të praktikave më të mira në fakultet, dhe arsimimin e lidërve të tanishëm dhe të ardhshëm si edhe vendimmarrësve.

Misioni i përgjithshëm i FIN-it bazohet në ndershmërinë, kuriozitetin, kreativitetin, lirinë, bashkëpunimin dhe transferimin e njohurive në fushën e shkencës dhe arsimit për një zhvillim të qëndrueshëm.

Me aprovimin dhe zbatimin e këtij plani për veprimin ndaj klimës, për më tepër, Fakultetit i Inxhinierisë së Ndërtimit ka si qëllim:

- Të ndihmojë zhvillimin dhe fuqizimin e lidërve të ardhshëm drejt qëndrueshmërisë përmes aktiviteteve të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimit shkencor.
- Të nxisë studentët, stafin e FIN, dhe një komunitet më të gjërë të bëhen qytetarë aktivë në drejtim të çështjeve të qëndrueshmërisë.
- Të minimizojë ndikimin në mjedis të zhvillimit infrastrukturor, kërkimor dhe mësimor në nivel lokal, rajonal dhe global.

## 2 Kapitulli 2: Vështrim i përgjithshëm lidhur me qëndrueshmërinë dhe planin e veprimit për klimën

Plan i veprimit për Klimën do të zhvillohet përmes fushave të veprimit të poshtëpërmendura. Identifikimi i fushave në të cilat do të veprohet është bërë duke u bazuar në prioritetet e veprimit për Institucionet e arsimit të lartë. Për secilën prej fushave, është theksuar qëllimi i veprimeve konkrete të propozuara.



Co-funded by  
the European Union

Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or EACEA. Neither the European Union nor the granting authority can be held responsible for them."

### **2.1 Qëndrueshmëria mjedisore në fushën akademike: Të mësuarit, kërkimi shkencor dhe mësimdhënia**

- Të ndihmojë në zhvillimin dhe fuqizimin e liderve të tanishëm dhe në të ardhmen në qëndrueshmëri, përmes aktiviteteve tona të të mësuarit dhe të nxënësve. Për të nxitur arsimimin e qëndrueshëm përmes mundësive të të mësuarit formal dhe joformal.
- Të ndihmojë në zhvillimin dhe fuqizimin e liderëve të ardhshëm në qëndrueshmëri përmes aktiviteteve tona kërkimore dhe, duke e bërë këtë, të ruajmë dhe përmirësojmë pozicionin dhe udhëheqjen e Universitetit në kërkimin mbi temat e qëndrueshmërisë.

### **2.2 Qytetaria, qëndrueshmëria**

- Të mbështesim, të mundësojmë dhe të ndikojmë studentët, stafin dhe komunitetin tonë më të gjerë në realizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-ve) dhe të vendosim Qytetarinë e Qëndrueshme si një etikë thelbësore e IAL-ve.
- Të jemi transparent, të përgjegjshëm dhe gjithëpërfshirës dhe të marrim vendime të drejta, si elemente thelbësore të programeve tona të studimit.

### **2.3 Veprimi për klimën**

- Të ndërtojë dhe të funksionojë brenda buxhetit të reduktimit të karbonit të IAL-ve dhe të zbusë ndikimin e ndryshimeve klimatike në vendin tonë, duke vepruar si lider për veprimin klimatik në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, duke synuar arritjen e emetimeve neto zero deri në vitin 2050.

### **2.4 Reduktimi i mbetjeve dhe ekonomia qarkulluese**

- Të minimizojë ndikimet mjedisore lokale, rajonale dhe globale të zhvillimit tonë arsimor, kërkimor, zbatues dhe infrastrukturor.



**Co-funded by  
the European Union**

Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or EACEA. Neither the European Union nor the granting authority can be held responsible for them.”



- Të ripërdorë opsinin e parë dhe të promovojë një qasje të ekonomisë qarkulluese në çdo kohë.

### 2.5 *Pejsazhi dhe burimet natyrore*

- Të promovojë angazhimin për krijimin e hapësirave të gjelbra të kampusit dhe shfrytëzimin e tij nga komuniteti i kampusit dhe ai lokal.

### 2.6 *Udhëtimet për punë dhe lëvizjet*

- Të promovojë përdorimin e metodave më të qëndrueshme të udhëtimit midis stafit dhe studentëve tanë.
- Të përfitojmë nga mundësitë, për të reduktuar emetimet tona të lidhura me transportin.

### 2.7 *Siguria ushqimore dhe mirëqënia*

- Të përmirësojë shëndetin dhe mirëqenien në Universitet dhe komunitetin më të gjerë përmes lehtësimit dhe promovimit të aspekteve të të ushqyerit dhe të jetuarit të shëndetshëm si pjesë integrale e jetesës së qëndrueshme.
- 

## 3 Kapitulli 3 : Monitorimi dhe Raportimi

Qendra e re (HUB) e krijuar për Njohuritë mbi klimën dhe qëndrueshmërinë (KHCS) do jetë përgjegjëse për raportimin dhe komunikimin e rezultateve të pritshëm. Për secilin nga veprimet apo grup veprimesh do të ngrihet një grup veprimi i posaçëm i cili do të mbikqyrë ecurinë e tyre dhe do të sigurojë përfundime të suksesshëm. Grup veprimi do të përbëhet nga një përfaqësues i stafit të Qendrës për njohuritë mbi klimën dhe qëndrueshmërinë, një student i doktoraturës dhe një përfaqësues staf nga administrata e FIN-it. Secili grup veprimi do të përgatitë Raportet e Qëndrueshmërisë duke nënvizuar progresin për çdo veprim dhe objektiv brenda këtij plani.



Co-funded by  
the European Union

Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or EACEA. Neither the European Union nor the granting authority can be held responsible for them.”

Përfaqësuesi nga Qendra për njohuritë mbi klimën dhe qëndrueshmërinë, do të raportojë tek Dekani i FIN-it për progresin e planit të veprimit.

Qendra për njohuritë mbi klimën dhe qëndrueshmërinë do të vazhdojë të funksionojë si një hapësirë e hapur për stafin dhe studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit për të vënë në jetë nisma dhe projekte të reja dhe të suksesshëm për të gjithë komunitetin e FIN-it.



**Co-funded by  
the European Union**

Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or EACEA. Neither the European Union nor the granting authority can be held responsible for them."

## 4 Plani i Veprimit

Nr.	Fushat	Objektivat	Aktivitetet	Përfitimet	Afati përfundimtar	Përgjegjësit	Prioritetet
1	<b>Qëndrueshmëria mjedisore në fushën akademike: Të mësuarit, kërkimi shkencor dhe mësimdhënia</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Promovimi i kërkimit shkencor në fushën e qëndrueshmërisë mjedisore.</li> <li>- Zvogëlimi i ndikimit në mjedis të praktikave tona kërkimore.</li> <li>- Mbështetja e stafin tonë mësimdhënës për të integruar OZHQ-të në kurrikulat e tyre aty ku është e përshtatshme.</li> <li>- Sigurimi që çdo student në DIM të jetë i informuar për axhendën globale të qëndrueshmërisë dhe këtij plani veprimi</li> <li>- Promovimi i bashkëpunimit dhe ndërthurjen e ndërdisiplinave në FIN.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbështetja e kërkuesve shkencorë për të kuptuar ku puna e tyre ndikon në mjedis dhe OZHQ-të.</li> <li>- Prezantimi me parimet e qëndrueshmërisë mjedisore dhe të OZHQ-ve tek studentët dhe stafi mësimdhënës.</li> <li>- Mbështetja e komunitetit akademik drejt bashkëpunimit ndërdisiplinar.</li> <li>- Zhvillimi i kurseve të vazhdueshme të zhvillimit profesional për qëndrueshmërinë dhe veprimin ndaj klimës për politikëbërësit, biznesin dhe komunitetin.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndryshimet e kurrikulave dhe kërkimi shkencor sipas OZHQ-ve</li> <li>- Rritja e të kuptuarit dhe ndërgjegjësimit për parimet mjedisore në mesin e komuniteteve të studentëve.</li> <li>- Shkëmbimi i njohurive midis studentëve, komunitetit akademik dhe aktorëve të jashtëm në fushën e mjedisit.</li> </ul>	2027	I gjithë stafi akademik, ndihmes-akademik dhe administrativ i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit si dhe studentët	I lartë
2	<b>Qytetaria, qëndrueshmëria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përafrimi i programit për qëndrueshmërinë me strategjitë përkatëse të FIN-it duke përfshirë mësimdhënien dhe të nxëniet dhe strategjitë e kërkimit shkencor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillimi i trainimeve lidhur me OZHQ-të për stafin dhe studentët e FIN-it.</li> <li>- Zhvillimi i një procesi raportimi për</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Stafi dhe studentët e FIN të trainuar për OZHQ-të</li> </ul>	2026	I gjithë stafi akademik, ndihmes-akademik dhe administrativ i Fakultetit të Inxhinierisë së	I lartë



Co-funded by  
the European Union

Funded by the European Union. Views and

opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or EACEA. Neither the European Union nor the granting authority can be held responsible for them.

		- Një ndërtesë e qëndrueshme e FIN-it.	qëndrueshmërinë transparent dhe bashkëkohor.			Ndërtimit si dhe studentët	
3	<b>Veprimi për klimën</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zbatimi dhe përshtatja e politikave dhe infrastrukturës sonë të menaxhimit institucional për të zbutur ndikimet e ndryshimeve klimatike.</li> <li>- Mbështetja e studentëve, stafit dhe komunitetit të gjerë për të reduktuar nivelet e konsumit të energjisë përmes rritjes së efikasitetit të energjisë dhe përdorimit të energjisë së rinovueshme.</li> <li>- Ndikimi pozitivisht në performancën e qëndrueshmërisë së furnitorëve dhe kredencialet e qëndrueshmërisë së mallrave dhe shërbimeve që blejmë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vazhdimi i praktikave më të mira të ruajtjes së energjisë, ndërtimit dhe rindërtimit, nismave të ndryshimit të sjelljes dhe programeve të zëvendësimit të pajisjeve.</li> <li>- Prezantimi i kritereve eko dhe mjedisore në procedurat e tenderimit për materiale dhe shërbime nga palët e treta.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Më pak emetime karboni (C).</li> <li>- Kapacitete të rinovueshme brenda godinës së FIN.</li> <li>- Reduktim i sasisë vjetore të energjisë së përdorur</li> <li>- Të gjithë furnizuesve do tu kërkohet të zbatojnë gjurmën e karbonit</li> </ul>	2029	I gjithë stafi akademik, ndihmes-akademik dhe administrativ i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit si dhe studentët	I lartë
4	<b>Reduktimi i mbetjeve dhe ekonomia qarkulluese</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përdorimi i materialeve një përdorimshe pa përmbajtje plastike, në të gjitha aktivitetet tuaja dhe punoni me një komunitet më të gjerë për të minimizuar konsumin e plastikës në laboratorë.</li> <li>- Promovimi i ripërdorimit si opsionin kryesor, për të promovuar një ekonomi të qëndrueshme në fakultet dhe në komunitet.</li> <li>- Sigurimi i një model të kostos, së ciklit të jetës së plotë, si pjesë e proceseve të tenderimit dhe</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendosija në mjediset e fakultetit të infrastrukturës së nevojshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.</li> <li>- Kryerja e një vlerësimi të plotë të mbetjeve laboratorike.</li> <li>- Puna me Zyrën e Prokurimit për t'u angazhuar me furnitorët në reduktimin e mbetjeve dhe zbatimin e një modeli të ciklit të jetës për</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Grumbullim i diferencuar i mbetjeve.</li> <li>- Minimizim i përdorimit të plastikës.</li> <li>- Reduktimi i ndikimit mjedisor të depozitimit të mbetjeve nëpërmjet metodave të duhura të riciklimit.</li> </ul>	2025	I gjithë stafi akademik, ndihmes-akademik dhe administrativ i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit si dhe studentët	I lartë



Co-funded by  
the European Union

Funded by the European Union. Views and

opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or EACEA. Neither the European Union nor the granting authority can be held responsible for them."

		<ul style="list-style-type: none"> <li>blerjeve të përditshme të fakultetit.</li> <li>Aplikimi i modele të reja për reduktimin dhe ripërdorimin e mbetjeve në bashkëpunim me aktorë të brendshëm dhe të jashtëm.</li> <li>Promovimi i një kuptim më të mirë të llojeve të mbetjeve të krijuara nëpër departamente dhe zhvillimi i një strategjie për ripërdorimin e këtyre materialeve.</li> <li>Sigurimi i praktikave më të mira në menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>materialet dhe për të gjitha aktivitetet.</li> <li>Bashkëpunimi me zyrën e IT për të promovuar ripërdorimin efikas dhe riparimin e pajisjeve të IT</li> <li>Promovoni ripërdorimin e artikujve të zyrës dhe materialeve të konsumit në ambientet e fakultetit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kontributi në një ekonomi qarkulluese duke maksimizuar rikuperimin dhe ripërdorimin e materialeve të riciklueshme.</li> </ul>			
5	<b>Pejsazhi dhe burimet natyrore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Promovimi i një integrimi më të mirë dhe lidhje të hapësirave të gjelbra në të gjithë ndërtesën e FIN-it dhe rrethinat e saj.</li> <li>Nxitja dhe përdorimi i sa më shumë burimet tona natyrore në mësimdhënie dhe mësimnxënie dhe kërkim shkencor mbi qëndrueshmërinë, si dhe në përdorimin dhe rekreacionin e përditshëm.</li> <li>Promovimi dhe lehtësimi i aksesit social dhe fizik në hapësirën e gjelbër, dhe rritja e ndërgjegjësimit për ekosistemin, biodiversitetin, trashëgiminë, vlerat sociale dhe shëndetësore.</li> <li>Kursimi i ujin duke rritur efikasitetin e përdorimit të tij dhe duke ulur ndotjen e ujit të përdorur.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Inkorporimi i infrastrukturës së gjelbër dhe parimet e projektimit biophilic në ndërtimet e reja dhe rinovimet kryesore.</li> <li>Ndërtimi i mureve/çative të gjelbra në ndërtesat e reja.</li> <li>Ndërtimi i vendkalimeve dhe rrugë të gjelbra për të siguruar akses në hapësirën tonë të gjelbër.</li> <li>Hartimi i standardeve për efikasitetin e ujit.</li> <li>Hartimi i standarteve të grumbullimit të ujërave të shiut.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Më shumë hapësira të gjelbra në ndërtesën e FIN dhe përreth saj.</li> <li>Përdorim eficient i burimeve natyrore.</li> <li>Reduktimi i humbjes së ujit dhe rritja e efikasitetit në përdorimin e ujit në mjediset e synuara.</li> </ul>	2029	I gjithë stafi akademik, ndihmes-akademik dhe administrativ i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit si dhe studentët	I lartë



Co-funded by  
the European Union

Funded by the European Union. Views and

opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or EACEA. Neither the European Union nor the granting authority can be held responsible for them."

6	<b>Udhëtimet për punë dhe lëvizjet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zvogëlimi i numrit të stafit dhe studentëve që udhëtojnë drejt fakultetit me makina personale.</li> <li>- Zvogëlimi i emetimeve të përgjithshme të karbonit që lidhen me udhëtimin e stafit dhe studentëve në FIN.</li> <li>- Mbështetja e stafit dhe studentëve në zgjedhjen e opsioneve më të qëndrueshme të transportit duke ofruar stimujt e duhur dhe përmirësimet infrastrukturore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndryshimi gradual i flotës së makinave/mjeteve të transportit në përgjithësi drejt atyre elektrike apo hibride.</li> <li>- Puna me institucionet partnere dhe këshillin bashkiak për të nxitur ofrimin e infrastrukturës më të mirë të biçikletave dhe transportit publik.</li> <li>- Ndërtimi i një parkimi të mbuluar për biçikleta. Zhvillimi dhe pilotimi i një strategjie komunikimi dhe programim për të reduktuar lëvizjen e automjeteve që kërkojnë një parkim.</li> <li>- Promovimi i videokonferencave si një alternativë për të shmangur udhëtimin ajror.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vend i përpshatur për të ruajtur biçikleta të disponueshme brenda FIN-it.</li> <li>- Rritja e aftësisë së stafit dhe studentëve në përdorimin efektiv të mjeteve të videokonferencës për takime virtuale, leksione dhe projekte bashkëpunuese, duke rezultuar në një frekuencë më të lartë të ndërveprimeve virtuale dhe reduktim të emetimeve të lidhura me udhëtimin</li> </ul>	2029	I gjithë stafi akademik, ndihmes-akademik dhe administrativ i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit si dhe studentët	Mesatar
7	<b>Siguria ushqimore dhe mirëqënia</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sigurimi që i gjithë komuniteti i fakultetit të ketë akses në opsionet e ushqimit të shëndetshëm dhe të përballueshëm me bazë bimore.</li> <li>- Sigurimi i një cilësi të shëndetshme të ajrit për të gjithë stafin dhe studentët brenda dhe jashtë, dhe promovimi i iniciativave për cilësinë e ajrit në një komunitet më të gjerë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Punoni për zgjedhje sa më vegane në restorante dhe bare të fakultetit.</li> <li>- Mbështetni udhëtimin aktiv përmes parashikimit të vendit të ruajtjes së biçikletave.</li> <li>- Hartimi dhe zbatimi i një rregulloreje për pastrimin dhe dezinfektimin e mjediseve, me qëllim</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rritja e shëndetit dhe mirëqenies së komunitetit të FIN-it.</li> <li>- Inkurajon transportin aktiv dhe përgjegjësinë sociale.</li> <li>- Rritja e ndërgjegjësimit dhe respektimit</li> </ul>	2029	I gjithë stafi akademik, ndihmes-akademik dhe administrativ i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit si dhe studentët	Mesatar



Co-funded by  
the European Union

Funded by the European Union. Views and

opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or EACEA. Neither the European Union nor the granting authority can be held responsible for them."

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbështetja e stafit dhe studentëve që të përdorin mënyrat aktive të transportit në lëvizjet e tyre të përditshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- ruajtjen/përmirësimin e cilësisë së ajrit.</li> <li>- Krijimi i zonave të gjelbra rekreative me mjedise të hapura.</li> <li>- Rritja e aktivitete të shëndetshme jashtëshkollore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të rregulloreve dhe standardeve për pastrimin dhe dezinfektimin.</li> <li>- Motivon angazhimin e komunitetit dhe ndikimin afatgjatë përtej kampusit.</li> </ul>			
--	--	---	--	--	--	--	--



Co-funded by  
the European Union

Funded by the European Union. Views and

opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or EACEA. Neither the European Union nor the granting authority can be held responsible for them.”

# 1 FUTURE



LUNDS  
UNIVERSITET



LUARASI



AKKSHI



AZURI

I  
- - -  
U  
- - -  
A  
- - -  
V



Montenegro  
Ministry of Ecology,  
Spatial Planning and Urbanism



Co-funded by  
the European Union

Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or EACEA. Neither the European Union nor the granting authority can be held responsible for them.